

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Bee2Com” sh.p.k.

Sot, me date 08 Shkurt 2022, une i neneshkruari:

- Z. Jean-Guillaume, Paul Dubuis, Shtetas Francez, lindur ne Nogent-Sur-Marne France me 28.11.1975 me atesi Z. Robert, banues ne “50 rue Marx Dormoy, 42300 Roanne, France”, mbajtes i dokumentit te identitetit me numer: 12DI95314, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” (i ndryshuar) kam vendosur te themeloj nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar “Bee2Com” sh.p.k (me poshte referuar si “Shoqeria”), duke neneshkruar kete Akt Themelimi, Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte “Bee2Com” sh.p.k.

Neni 2

Selia e Shoqerise ndodhet ne Adresen: “Rruga Dritan Hoxha, ndertesa 203, zip 1023, Laprake, Tirane”. Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, gjate aktivitetit te saj.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si vijon:

- Aktivitet ne fushen e teknologjise se komunikimit dhe informacionit;
- Sherbime ne fushen e internetit;
- Sherbime Hostimi;
- Marketing dhe Komunikim.

Neni 5

Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 120 000 (njqind e njezetemije) leke dhe i ndare ne 1 pjese (kuota) me vlere nomiale 120 000 (njqind e njezetemije) leke.

Kapitali zoterohet nga ortaku i shoqerise si me poshte:

-Z. Jean-Guillaume, Paul Dubuis, i cili zoteron 1 kuote te Shoqerise ose 120 000 (njqind e njezetemije) leke qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te Shoqerise.

Ortaku i Shoqerise mund te vendos te rrisi kapitalin e Shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise. Detyrimet e ortakut te shoqerise kundrejt Shoqerise do te mbulohet vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij.

Neni 6

Shoqeria vepron nen rregjimin e prones private dhe merr persiper vetes te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhtme:

-Asambleja e Pergjithshme;

-Administratori;

Kompetencat e Asmblese se Pergjithshme si dhe te administratorit te Shoqerise jane te parashkuara ne Statutin e Shoqerise.

Neni 7

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet, e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

Neni 8

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimi dhe te punesuarit jane te detyruar qe ta respektojne Statutin e kesaj Shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe shkaktojne kesaj Shoqerie me veprimet dhe mosveprimet e tyre.

Neni 9

Ne rast se Shoqeria do te mbyll aktivitetin e saj per cdo lloj arsye, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te Shoqerise, percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Neni 10

Kontrolli mbi veprimtarine e Shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje eksperti kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve qe ben ligji per ekspertet dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Pergjithshme cakton edhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 11

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te secilit vit. Perjashtim, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakeve te Shoqerise.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Per sa eshte shprehur ne kete Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (i ndryshuar).

ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Bee2Com" sh.p.k.

DUBUIS JG

Emer Mbiemer Nenshkrimi

